VENDIM
Nr. 11, datë 13.2.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.1.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 79/17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Altin Vrioni

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria "Ndërtim Montim Patos" sh.a., Shoqëria "Rubin Petrol Patos" sh.a., Saimir Vrioni, Grabon Vrioni, Servete Tirana (Vrioni), Hedije Hoxha (Vrioni), Zija Vrioni, Arshi Vrioni.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-3261 (470), datë 18.9.2014 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 6, 17, 41, 42, 124, 131/f, 134/1/i, 141/1, 142/1 dhe 145/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë "Ndërtim Montimi Patos" sh.a., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 2, datë 19.12.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë Këshillit të Rrethit Fier, ndër të tjera, ka vendosur: "*1. Të njohë pronësinë e ish-pronarit, të ndjerit Kahreman Vrioni, mbi një sipërfaqe toke bujqësore prej 231 ha, e ndodhur në fshatin Grize-Godolesh, Bashkia Patos, me kufizime: V - me rrugë, L - me rrugë, J - me rrugë dhe P - me tokë bujqësore. 2. Trashëgimtarët ligjorë: 1) Servete Tirana, 2) Hedije Hoxha, 3) Demir Vrioni, 4) Zija Vrijoni dhe 5) Arshi Vrioni, të cilët gëzojnë në pjesë të barabarta nga 1/5, të marrin pjesë në aksione në ndërmarrjen e Ndërtim Montimit Patos dhe Rrugë Bazamenteve Patos, si pronarë të tokës me vlerën e saj. Për ndërmarrjen e Ndërtim Montimit Patos 30.980 m² dhe ndërmarrjen e Rrugë Bazamenteve Patos 18.221 m²*". Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë nga shoqëria "Ndërtim Montim Patos" sh.a. dhe "Rubin Petrol Patos" sh.a.

2. Me vendimin nr. 1522, datë 21.12.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur: "*Pranimin e padisë së palës paditëse "Ndërtim Montim Patos" sh.a. dhe "Rubin Petrol Patos" sh.a., ndaj palës së paditur, KKKP- së pranë Prefekturës së Qarkut Fier, Servete Tirana, Arshi Vrioni, Hedije Hoxha, Altin Vrioni, Zija Vrioni, Sonja Vrioni, Grabon Vrioni e Saimir Vrioni, duke kundërshtuar pikën 2 të vendimit nr. 2, datë 19.12.1995 të KKKP-së pranë ish-Këshillit të Rrethit Fier. Lënien në fuqi të pikave të tjera të vendimit të mësipërm të KKKP-së*". Ky

vendim ka marrë formë të prerë në datën 10.5.2002.

3. Në datën 7.1.2008, pala e paditur në procesin civil, Altin Vrioni, Saimir Vrioni, Grabon Vrioni, Servete Tirana (Vrioni), Hedije Hoxha (Vrioni), Zija Vrioni e Arshi Vrioni, i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit civil nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

4. Me vendimin nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.*".

5. Subjektet e interesuara, shoqëria "Ndërtim Montim Patos" sh.a. dhe "Rubin Petrol Patos" sh.a., i janë drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

6. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 18, datë 23.4.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se shoqëria "Rubin Petrol Patos" sh.a. nuk kishte marrë dijeni për procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 470, datë 18.9.2014, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

II

8. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt kërkese, pasi i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

8.1 Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ka marrë prerogativat që u takojnë gjykatave së shkallës së parë.

8.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse Gjykata e Lartë ka marrë një vendim diametralisht të kundërt me vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë lidhur me të drejtën e rishikimit.

8.3 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, sepse i ka mohuar kërkuesit të drejtën që të dëgjohet nga gjykata e shkallës së parë.

8.4 Gjykata e Lartë nuk ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse vendimi i saj është kontradiktor.

9**. Subjekti i interesuar, shoqëria "Ndërtim Montim Patos" sh.a.,** ka prapësuar me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

9.1 Gjykata e Lartë në respekt të kritereve ligjore të përcaktuara nga KPC-ja, të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të jurisprudencës kushtetuese ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet kumulative të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së. Gjykata e Lartë nuk ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ky vlerësim hyn në diskrecionin e saj.

9.2 Nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse është në kompetencë të Gjykatës së Lartë të vlerësojë nëse prova e paraqitur plotëson kriteret për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

9.3 Sipas jurisprudencës kushtetuese kërkuesit nuk i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi ai i është drejtuar gjykatës, si dhe ka marrë përgjigje për pretendimet e tij.

9.4 Vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për rishikim i ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

11. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi, *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve të ngritura në kërkesë

12. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ka marrë prerogativat që i takojnë gjykatës së shkallës së parë. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka shkuar tej kompetencave të saj të parashikuara nga neni 494 i KPC-së kur ka shqyrtuar vlefshmërinë dhe rëndësinë e provave lidhur me themelin e çështjes objekt konflikti. Po ashtu, sipas kërkuesit, është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse Gjykata e Lartë ka marrë një vendim diametralisht të kundërt me vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë lidhur me të drejtën e rishikimit, e drejta e aksesit në gjykatë, sepse Gjykata e Lartë i ka mohuar atij të drejtën të dëgjohet nga gjykata e shkallës së parë, si dhe nuk është respektuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse vendimi i saj është kontradiktor.

13. Subjekti i interesuar, shoqëria "Ndërtim Montim Patos" sh.a., ka prapësuar se Gjykata e Lartë, në respekt të kritereve ligjore të përcaktuara nga KPC-ja, duke u bazuar në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe në jurisprudencën kushtetuese, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet kumulative të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së. Gjykata e Lartë nuk ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ky vlerësim hyn në diskrecionin e saj. Gjithashtu, subjekti i interesuar, shoqëria "Ndërtim Montim Patos" sh.a., ka prapësuar se nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse është në kompetencë të Gjykatës së Lartë të vlerësojë nëse prova e paraqitur plotëson kriteret për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë; sipas jurisprudencës kushtetuese kërkuesit nuk i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi ai i është drejtuar gjykatës, si dhe ka marrë përgjigje për pretendimet e tij; vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për rishikim i ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

14. Sipas nenit 72/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Me ndryshimet që iu bënë këtij ligji me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, në nenin 73 është shtuar pika 4 sipas së cilës kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

15. Gjykata vëren, pas shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, se asnjë nga argumentet e paraqitura nga kërkuesi nuk arriti të merrte shumicën e votave të gjyqtarëve të kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, nisur nga sa më lart, kërkesa konsiderohet e rrëzuar[1].

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 73/4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

[1] Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët: Vladimir Kristo, Vitore Tusha dhe Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo